

2019-2020

MICS në Republikën e Kosovës

dhe

MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës

## Zhvillimi në Fëmijëri të Hershme (ZHFH)

MICS


Anketa e Treguesve të Shumëfishtë

Mbështetje për të mësuar




### Stimulimi i hershëm dhe kujdesi i përgjegjshëm

Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 2-4 vjeç me të cilët babai, nëna ose anëtarët e rritur të ekonomisë familjare u angazhuan me aktivitete që promovojnë të mësuarit dhe përgatitjen për shkollë gjatë tre ditëve të fundit.

### Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 2-4 vjeç me të cilët babai, nëna ose anëtarët e rritur të ekonomisë familjare u angazhuan me aktivitete që promovojnë të mësuarit dhe përgatitjen për shkollë gjatë tre ditëve të fundit.

Shënim: Aktivitetet përfshijnë: leximi i librave fëmijës; tregimi i rrëfimeve fëmijës; këndimi i këngëve fëmijës; shëtitja e fëmijës jashtë shtëpisë; luajtja me fëmijën; dhe emërtimin, numërimin ose vizatimin e gjërave me fëmijën.


Fëmijëria hershme, e cila zgjatë në periudhën deri në moshën 8 vjeçare, është vendimtare për zhvillimin kognitiv, social, emocional dhe fizik. Gjatë këtyre viteve, truri i ri në zhvillim i fëmijës është shumë elastik dhe reagon ndaj ndryshimeve. Për zhvillimin optimal në fëmijërinë e hershme nevojitet një mjedis stimulues dhe edukues, qasje në libra dhe materiale mësimore, ndërveprime me kujdestarë të përgjegjshëm dhe të vëmendshëm, vlera ushqyese të duhura, qasje në edukim në fëmijërinë e hershme me cilësi të lartë dhe siguri dhe mbrojtje.

Fëmijët që përballen me një gamë të gjerë të faktorëve të rrezikut, përfshirë varfërinë, shëndetin e dobët, nivelet e larta të stresit familjar dhe mjedisor dhe ekspozimi ndaj dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit; dhe mundësi të papërshtatshme për kujdes dhe mësim përballen me pabarazi dhe mund të dështojnë të arrijnë potencialin e tyre të zhvillimit. Investimi në vitet e hershme është njëra nga mënyrat më të rëndësishme dhe me kosto efektive që vendet t'i zvogëlojnë boshllëqet, të cilat shpesh i vendosin fëmijët me status të ulët social dhe ekonomik në dizavantazh.

## Mesazhet kryesore


- Rreth 2 në 3 fëmijë të moshës 2-4 vjeç në popullsinë e përgjithshme dhe 1 në 3 fëmijë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian kanë pasur kujdes stimulues dhe të përgjegjshëm nga pjesëtarët e rritur të ekonomisë familjare në tri ditë para anketave.
- Fëmijët e moshës 2-4 vjeç kanë më shumë gjasa të angazhohen deri në 4 herë më shumë në aktivitete që e promovojnë të mësuarit nga nënat se sa baballarët e tyre.
- Vetëm 15 përqind e fëmijëve të moshës 3-4 vjeç nga popullsia e përgjithshme i vijnë programet për edukim në fëmijëri të hershme. Kjo përqindje është më e ulët të fëmijët që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, me 8 përqind.
- Në popullsinë e përgjithshme, fëmijët e moshës 3-4 vjeç kanë më shumë gjasa që të vijnë programin e edukimit në fëmijërinë e hershme nëse jetojnë në zona urbane, ekonomitë familjare më të pasurat dhe nëse nënat e tyre kanë arsim të lartë.
- 9 nga 10 fëmijë të moshës 3-4 vjeç në popullsinë e përgjithshme dhe 8 nga 10 në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë në rrugën e duhur zhvillimore në së paku tri nga katër fushat (fushën e shkrimit leximit/numërimit, fushat fizike, sociale-emocionale dhe të mësuarit).
- Një përqindje e ulët e fëmijëve kanë qasje në material mësimor, me vetëm 27 përqind të fëmijëve në popullsinë e përgjithshme që kanë 3 apo më shumë libra në shtëpi dhe 4 përqind të atyre që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

## Vijimi i programeve për edukimin në fëmijërinë e hershme



Përqindja e fëmijëve të moshës 3-4 vjeç që vijojnë programin në fëmijërinë e hershme, sipas karakteristikave të përgjithshme

### Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e fëmijëve të moshës 3-4 vjeç që vijojnë programin në fëmijërinë e hershme, sipas karakteristikave të përgjithshme

(R) Indeksi i pasurisë është ndërtuar duke përdorur informacionin mbi asetet e ekonomive familjare me supozimin se kjo reflektonte pasurinë afatgjatë, duke i renditur ekonomitë familjare sipas pasurisë, nga më të varfërat te ato më të pasurat. Llogaritjet janë kryer veçmas në mostrën për MICS për Kosovën dhe mostrën për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në MICS për Kosovën, duke përdorur karakteristikat për secilën mostër përkatëse. Rezultatet e pasurisë të llogaritura, pra janë të zbatueshme vetëm për të dhënat e veçanta në të cilat bazohen dhe ndryshojnë për dy anketat. Gjetjet sipas rezultateve të pasurisë të llogaritura për MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian tregohen me '(R)' në grafikun.

## Materialet mësimore dhe mbikëqyrja e fëmijës


### Qasja në materialet për lojë dhe mësim

#### Kosovë



Përqindja e fëmijëve nën moshën pesë vjeçare sipas qasjes së tyre në materialet për lojë dhe mësim

#### Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve nën moshën pesë vjeçare sipas qasjes së tyre në materialet për lojë dhe mësim


### Mbikëqyrja jo adekuate e fëmijëve

	Është lënë me mbikëqyrje jo adekuate
<b>Kosovë</b>	<b>7</b>
Urban	7
Rural	6
<b>Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë</b>	<b>9</b>
Urban	7
Rural	11

Përqindja e fëmijëve nën moshën pesëvjeçare që janë lënë vetëm apo nën mbikëqyrjen e një fëmije tjetër nën moshën 10 vjeçare për më shumë se një orë, të paktën një herë në javën e fundit, sipas vendbanimit


## Indeksi i zhvillimit të hershëm të fëmijës (IZHHF)

### IZHHF: Rezultati i përgjithshëm dhe fushat, SDG 4.2.1




IZHHF: Indeksi i zhvillimit të hershëm të fëmijës; përqindja e fëmijëve të moshës 3-4 vjeçare që janë në rrugë të duhur zhvillimore në shkrim lexim/numërim, fushë fizike, sociale-emocionale dhe të mësuari

### IZHHF: Zbërthimet




IZHHF sipas karakteristikave të ndryshme  
EFH = Edukimi në Fëmijëri të Hershme  
( ) Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

### IZHHF: Rezultati i përgjithshëm dhe domenet, SDG 4.2.1



IZHHF: Indeksi i zhvillimit të hershëm të fëmijës; përqindja e fëmijëve të moshës 3-4 vjeçare që janë në rrugë të duhur zhvillimore në shkrim lexim/numërim, fushë fizike, sociale-emocionale dhe të mësuari

### IZHHF: Ndarjet



IZHHF sipas karakteristikave të ndryshme  
Të dhënat sipas vijimit të edukimit në fëmijëri të hershme nuk janë paraqitur sepse përqindja e fëmijëve që vijojnë bazohet në më pak se 25 raste të papeshuara  
( ) Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë realizuar në 2019-2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si pjesë e programit global MICS. Mbështetja teknike u sigurua nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), me fonde të siguruar nga Ministria e Financave (MF), Qeveria e Luksemburgut, Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë (MFK), UNICEF, Ekipi i Kombeve të Bashkuara të Kosovës (UNKT), Fondi i Popullsisë i Kombeve të

Bashkuara (UNFPA) dhe UN Women. Qëllimi i kësaj pasqyre të shkurtër informative është shpërndarja e gjetjeve të zgjedhura nga MICS e Kosovës 2019-2020 dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2019-2020 në Kosovë lidhur me Indeksën e Zhvillimit të Hershëm të Fëmijës (ZHHF). Të dhënat nga kjo pasqyrë e shkurtër informative mund të gjenden në tabelat TC.10.1, LN.1.1, TC.10.2, TC.10.3 dhe TC.11.1 në Raportin e Gjetjeve të Anketës (treguar me shkronjën 'R' për MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe

Egjiptian në Kosovë). Pasqyrat tjera të shkurtra informative statistikore dhe Raporti i Gjetjeve të Anketës për këtë anketë dhe anketa të tjera janë në dispozicion në [mics.unicef.org/surveys](https://mics.unicef.org/surveys).